



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:256976

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05745733

**C.nr.4250/2023**

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtare Diara Bajrami, me bashkëpunëtorin profesional D.K. në çështjen kontestimore të paditëses Y.S.S. me numër personal ..... nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës M.A.Sh.T. dhe Inovacionit me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 568.69 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 28.05.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses Y.S.S. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura M.A.Sh.T. që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore Nëntor - Dhjetor 2020, në shumën prej 1.73 euro;
2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 177.02 euro;
3. Për periudhën kohore Janar - 30.04.2022, në shumën prej 201.37 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 380.12 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (13.11.2023), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura M.A.Sh.T. dhe Inovacionit me seli në Prishtinë, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit të ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 568.69 euro, përkatësisht shuma prej 188.57 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

## A r s y e t i m

Paditësja Y.S.S. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 13.11.2023, përmes të autorizuarit të saj, av. A.H. nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit me seli në Prishtinë, duke kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 01.01.2019 deri më 30.04.2022, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune në shkollën-Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Lef Nosi” në Prizren dhe bazuar në nenin 35 par. 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 01.01.2019, 2020, 2021 dhe 30.04.2022, është në lartësi prej 568.69 euro. Po ashtu, ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditësit vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

M.A.Sh.T. dhe Inovacionit me seli në Prishtinë,, përmes Avokaturës Shtetërore, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 02.02.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Ka theksuar se sipas nenit 90 para.4 të Ligjit të Punës “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”. Po ashtu bazuar në nenin 341 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcaktohet “Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë”. Po ashtu, bazuar në këtë dispozitë ligjore MASHT konsideron se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.01B/2056 e datës 18.04.2017 është shfuqizuar në bazë të nenit 47 të Kontratës Kolektive e Arsimit në Kosovë nr.01B/105 e datës 22.01.2021, gjithashtu bazuar edhe në faktin se MASHT me datën 21.11.2022 është tërhequr nga Kontrata Kolektive nr.prot.01B/105 e datës 22.01.2021 e Arsimit në Kosovë dhe si e tillë kjo kontratë nuk mund të zbatohet. Në fund ka theksuar paditësi me asnjë provë të vetme nuk ka dëshmuar se ishte anëtar i SBASHK-ut, ashtu siç parashihet në dispozitën ligjore të nenit 35 par.8 dhe 9 të Kontratës Kolektive nr.01/B105 të datës 22.01.2021 të Arsimit në Kosovë. Duke u bazuar në thëniet e cekura më lartë e paditura kërkon që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës numër 3/1048-119 e datës 11.09.2017 për paditësen e lëshuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës - e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në shkollën-Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Lef Nosi” në Prizren, si mësimdhënëse lëndore.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 434.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që “Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.11.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2020 ka qenë 434.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 1.73 euro ( $434 * 0.2\% = 0,86 * 2 \text{ muaj} = 1.73 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2021 ka qenë 434.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 177.02 euro ( $434 * 3.4\% = 14.75 * 12 \text{ muaj} = 177.02 \text{ euro}$ ).
- Për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 30.04.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditësit në vitin 2022 ka qenë 434.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 201.37 euro ( $434 * 11.6\% = 50.34 * 4 \text{ muaj} = 201.37 \text{ euro}$ ).
- Apo në shumën e përgjithshme prej 380.12 euro për periudhën 01.11.2020 deri me dt. 30.04.2022.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që “Kur gjykata, pasi t’i arrijë

*përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e kanë parashtruar më datë 13.11.2023. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 01.01.2019 deri më datë 31.10.2020.*

Me paraqitjen e padisë në gjykatë më datë 13.11.2023, në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.11.2020 e deri më 30.04.2022. Edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 13.11.2023, gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin nëntor 2020, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditëses për muajin nëntor 2020 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që e njëjta ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht e njëjta pas pranimi të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin nëntor 2020 dhe nga fillimi i muajt vijues saktësisht dhjetor 2020, e njëjta ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”.

Gjithashtu, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ia njohur paditëses kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit në pagën bazë të cilën e realizon paditësja dhe atë në shumën prej 434.00 euro, duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëses, e që është shuma prej 434.00 euro dhe jo siç është kërkuar nga paditësi në shumën prej 466.16 euro, pasi që kjo shumë përfshinë në vete edhe shtesat në pagë që i realizon paditësja.

Andaj, mbi këtë bazë, gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës nga data 01.01.2019 deri më datë 31.10.2020 si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësja në shumë prej 466.16 dhe asaj që paditësja e realizon e që është në shumë prej 434.00 euro, pra shuma e tërësishme e parashkruar dhe pabazuar në lartësi prej 188.57 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (13.11.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL  
C.nr.4250/2023, datë 28.05.2024

G j y q t a r e

---

Diora Bajrami

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.